
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	<b>ZYRA E PERSONELIT          KANCELARIJA OSOBIJA</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr. 103/17	<b>Data:</b> 12.07.2017	

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës, Komuna e Istogut ,shpall:

**K o n k u r s**  
**Për plotësimin e vendit të lirë të punës**

Vendi i punës: Teknik/e i/e Dhëmbëve  
 Drejtorati : Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale  
 Numri i Ekzekutuesve: 1 ( një )  
 Paga mujore: 320 € në muaj  
 Kohëzgjatja e Emrimit : Me afat të caktuar ~ 5 ( pesë ) muaj , me mundësi vazhdimi  
 Orari i plotë : 40 orë në javë

**Detyrat :**

- Bënë përgaditjen e ordinancës stomatologjike për punë ;
- Kujdeset për higjienën e ordinancave stomatologjike;
- Bënë pastrimin dhe sterilizimin e instrumenteve dhe jep përgjegjësi për efikasitetin e tyre;
- Mbanë evidencën e pacientëve dhe materialit hargjues;
- Kujdeset për mirëvajtjen e aparaturave stomatologjike;
- Si dhe punë të tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi .

**Kushtet për punësim :**

- Të ketë të kryer shkollën e mesme të mjekësisë - drejtimi, teknik i dhëmbëve,
- Të ketë përvojë pune në profesion.

**Dokumentacioni i nevojshëm;**

- Kopja e dokumentacionit të kualifikimit(diploma e shkollës së mesme të mjekësisë - drejtimi, teknik : dhëmbëve),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikata e lindjes apo ekstrakti i lindjes,
- Dy rekomandime,
- Dëshmi qe nuk jeni i ndjekur penalisht.

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu qysh parashihet me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen në Zyrën së Personelit.

Afati i aplikimit është 8 ditë, nga shpallja publike në tabelen e shpalljeve dhe në Web taqë të Komunës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Menaxheri i Personelit

Fatmir Bytyci

